

RIGID SOMATIC EXPRESIONS IN FRENCH AND ALBANIAN

SHPREHJET E NGUROSURA SOMATIKE NË FRËNGJISHT DHE NË SHQIP

Shejnaze AJDINI-MURTEZI¹, Dëfrim SALIU²

^{1*} *Institute of Spiritual and Cultural Heritage of the Albanians – Skopje*

² *Department of French Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*

^{*}*Corresponding author e-mail: sheajdini@hotmail.com*

Abstract

This paper presents an attempt to analyze some rigid somatic expressions, or in other words, expressions which contain names of body parts, in Albanian and French. Through the usage of contrastive analysis, we will highlight the semantic similarities and differences that exist between these expressions as well as their equivalences arising from the actions of the two cultural contexts. Such expressions are numerous in both languages. The human body, with its parts, is one of the most eligible fields of phraseological studies. In the group of rigid expressions, almost all parts of the body are presented, from the head to toe.

Through the terms that permeate his body, man seeks the means to express the various aspects of life such as intellectual, material, social and cultural. The connection between language and culture is realized through the cultural motivation of phraseological expressions. For this exact reason, we are determined to establish the corpus for this study by selecting a certain number of phraseological expressions, namely rigid expressions, in particular those related to the specific cultural reality of the French and Albanian people, or more specifically, expressions with socio-cultural and affective connotation, which we have extracted from various lexicographical sources.

Keywords: *rigid expressions, equivalences, culture, body parts, affective.*

Përmbledhje

Ky punim paraqet një përpjekje për t'i analizuar disa shprehje të ngurosura somatike, ose thënë ndryshe, shprehje të cilat përmbajnë emra të pjesëve të trupit, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën frënge. Nëpërmjet analizës kontrastive do të vihen në pah ngjashmëritë dhe dallimet semantike që ekzistojnë midis këtyre shprehjeve si edhe ekuivalencat e tyre që dalin nga veprimi i dy konteksteve kulturore. Shprehjet e këtilla janë të shumta në të dy gjuhët. Trupi me pjesët e tij është një nga fushat më të privileguara të studimeve frazeologjike. Në grupin e shprehjeve të ngurosura, paraqiten pothuajse të gjitha pjesët e trupit, nga koka deri te këmbët.

Nëpërmjet termave që përshkruajnë trupin e tij, njeriu kërkon mjete për të shprehur aspekte të ndryshme të jetës si intelektuale, materiale, shoqërore e kulturore. Lidhja midis gjuhës dhe kulturës realizohet nëpërmjet motivimit kulturor të shprehjeve frazeologjike. Mu për këtë arsye, ne jemi përcaktuar që korpusin tonë për këtë studim ta themelojmë duke zgjedhur një numër të caktuar shprehjesh frazeologjike, gjegjësisht shprehjesh të ngurosura, në veçanti ato që lidhen me realitetin kulturor specifik të popullit francez dhe shqiptar, gjegjësisht shprehjet me konotacion sociokulturor e afektiv, e të cilat i kemi nxjerrë nga burime të ndryshme leksikografike.

Fjalët kyçe: *shprehjet e ngurosura, ekuivalencat, kulturë, pjesët e trupit, afektiv.*

1. Hyrje

Njësitë frazeologjike përbëjnë një fushë studimi mjaft interesante për shkak të karakterit të tyre jo shumë të qartë. Përkundër përdorimit të tyre në përditshmëri, si me gojë, ashtu edhe me shkrim, ato paraqesin vështirësi për specialistët të cilët merren me përshkrimin e tyre. Ndërlikueshmëria e njësive frazeologjike, të quajtura ndryshe edhe shprehje të ngurosura, nuk kufizohet vetëm në nivelin e përshkrimit të tyre, por ajo pasqyrohet edhe në nivelin e përkthimit. Për shembull, si do të mund të përkthehej shprehja «*ne pas avoir la langue dans sa poche*» që ka kuptim figurativ «*être très bavard* (llafazan)» nga një nxënës shqiptar?. Me gjasë, ai do të kuptonte se bëhet fjalë për një shprehje, por nuk mund të jemi të sigurt se e kupton domethënien e një shprehjeje të tillë metaforike.

Ndoshta mund të kuptonte se një person që nuk e ka gjuhën në xhep, do të thotë se ai nuk zotëron mirë një gjuhë. Sigurisht se gjatë përkthimit të një shprehjeje të tillë të ngurosur duhet të merren parasysh disa aspekte, e në veçanti vlera kulturore që ajo mbart me vete. Fushën e studimit tonë e kemi përkufizuar në analizën e shprehjeve të ngurosura që përmbajnë emërtime të pjesëve të trupit. Nëpërmjet termave që përshkruajnë trupin e tij, njeriu kërkon mjete për të shprehur aspekte të ndryshme të jetës si intelektuale, materiale, shoqërore e kulturore. Lidhja midis gjuhës dhe kulturës realizohet nëpërmjet motivimit kulturor të shprehjeve frazeologjike.

Mu për këtë arsye, ne jemi përcaktuar që korpusin tonë për këtë studim ta themelojmë duke zgjedhur një numër të caktuar shprehjesh frazeologjike, gjegjësisht shprehjesh të ngurosura, në veçanti ato që lidhen me realitetin kulturor specifik të popullit francez dhe shqiptar, gjegjësisht shprehjet me konotacion sociokulturor e afektiv. Nëpërmjet metodës krahasuese do të përpiqemi t'i gjejmë korrespondencat dhe dallimet midis dy gjuhëve përkatëse në lidhje me shprehjet e ngurosura frënge dhe shqipe, duke marrë për bazë fjalorët në vijim: *Dictionnaire des expressions et locutions* (2006) - Alain Rey & Sophie Chantreau; *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe* (2010) - Jani Thomai; *Fjalor tematik frëngjisht - shqip (Dictionnaire thématique français - albanais)* (1998) - Halit Halimi.

2. Frazelogjia (trajtesë teorike)

Studimet e para kushtuar frazeologjisë, gjegjësisht shprehjeve të ngurosura, zënë fill në pjesën e parë të shekullit XX. Linguisti i parë i cili i ka filluar kërkimet teorike në lidhje me frazeologjinë frënge është Charles Bally (1909). Ai flet për frazeologjinë si një disiplinë në «*Traité de Stylistique française*», ku aludon në lokucionet dhe në frazeologjinë: „*Si, dans un groupe de mots, chaque unité graphique perd une partie de sa signification individuelle ou n'en conserve aucune, si la combinaison de ces éléments se présente seule avec un sens bien net, on peut dire qu'il s'agit d'une locution composée [...] C'est l'ensemble de ces faits que nous comprenons sous le terme de phraséologie. (Nëse në një togfjalësh secila njësi grafike humb një pjesë të kuptimit individual ose gjithë kuptimin, nëse kombinimi i këtyre njësive paraqitet vetëm me një kuptim tepër të qartë, mund të flitet për një lokucion të kompozuar. Tërësinë e këtyre fakteve ne e përshijmë nën termin e përgjithshëm frazeologji)*“ (Bally, 1951, 65-66).

Teoria e Bally-t shërbeu si frymëzim edhe për studimet frazeologjike të rusishtes, gjermanishtes, hungarishtes, spanjishtes, por edhe të shqipes. Kah vitet e '70 të shekullit XX, frazeologjia ndahet nga leksikologjia dhe bëhet disiplinë më vete, me një objekt studimi të përcaktuar qartë dhe një metodologji konkrete. Në gjuhësinë shqiptare, vite me radhë, autorë të ndryshëm janë marrë me studime leksikologjike, në kuptimin e togfjalëshave apo shprehjeve frazeologjike, të ndërtimit të tyre gramatikor apo funksionit të tyre semantik në tekst, siç janë

Aleksandër Xhuvani, Mehmet Çeliku, Mahir Domi e tjerë, por i pari që i studioi nga këndvështrimi i disiplinës frazeologjike është Jani Thomai në «*Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*» (1981). Ai e përkufizon frazeologjinë gjuhësore si „*tërësia e atyre bashkimeve të qëndrueshme të fjalëve, që janë formuar historikisht e janë kristalizuar si njësi të pandashme dhe që nga ana e kuptimit kategorial janë të barasvlershme me një fjalë të vetme*“ (Thomai, 1981, 14).

Termat që përdoren sot në gjuhësi për shprehjet frazeologjike janë të shumta, si: idiomë, togfjalësh i qëndrueshëm (Çeliku, 1965), shprehje idiomatike, frazemë (Mel'cuk, 1988) frazeologjisëm, lokucion (Xhuvani, 1921), lokucione (Sheperi, 1927), lokusione pavetore (Cipo, 1949), sintagma frazeologjike, lokucione (Polguère, 2011) etj. Perceptimi i këtyre njësive ndryshon nga një gjuhëtar te tjetri.

Për të shprehur dhe kuptuar një bisedë, nuk mjafton të dimë vetëm fjalët, por duhet gjithashtu të zotërojmë kuptimin e grupit të fjalëve që kanë një formë autonome të ngurtësuar dhe një kuptim figurativ. Pra zotërimi i një gjuhe është zotërimi i një kulture dhe kjo, domosdoshmërisht përfshin zotërimin e shprehjeve të ngurosura. González-Rey thekson se shprehjet e ngurosura janë prezente në të gjitha bisedat e përdoruesve që zbatojnë të njëjtin kod gjuhësor, që ndajnë njohuri të njëjta, përvojat e njëjta, pikëvështrimet e njëjta. Shprehjet e ngurosura formojnë një koncept qenësor të gjuhës (González-Rey, 2007, 7).

Si frëngjishtja ashtu edhe shqipja është mjaft e pasur me shprehje të ngurosura që përmbajnë emra të pjesëve të trupit nëpërmjet të cilave pasqyrohen doket, zakonet, mentaliteti dhe kultura e dy popujve. Sipas të dhënave të cituara nga Colette Cortès-i, afër 1/3 e shprehjeve idiomatike në gjuhën frënge i referohen trupit të njeriut (1988, 88). Meqë ky studim ka për qëllim sistematizimin e shprehjeve të këtilla, ne kemi ndjekur një përçapje semantike dhe kulturore duke i klasifikuar ato në dy grupe: shprehjet me konotacion sociokulturor dhe ato me konotacion afektiv.

3. Shprehjet me konotacion sociokulturor

Fjalët janë të ngarkuara me konotacion sociokulturor. Aaatto herë përçojnë kujtime personale e herë përvoja të një grupi të caktuar apo edhe një kolektiviteti të tërë. Konotacionet sociokulturore shumë shpesh janë të lidhura edhe me stereotipet. Varësisht nga kolektivitetet, ekzistojnë konotacione të llojlloshme semantike sa i përket perceptimit të realitetit. Të flasësh një gjuhë të huaj nënkupton, domosdoshmërisht të kesh njohuri edhe për sjelljet sociale të popullit që e flet atë gjuhë. Kjo do të thotë se lidhja në mes të gjuhës dhe kulturës është e pandashme. Një numër i madh i shprehjeve të ngurosura përmbajnë vlera semantike që mund të merren si veçori të një gjuhe.

Si në gjuhën frënge ashtu edhe në gjuhën shqipe, pjesët e trupit ndërlidhen me konotacione sociokulturore si kapacitetet intelektuale, cilësitë, të metat, sjelljet e individit, shoqërisë etj. Roli simbolik i emrave të ndryshëm të organeve varet para së gjithash nga lidhshmëria me kulturën e dhënë. Për shembull, koka dhe zemra kanë një mbizotërim të madh, që do të thotë edhe një llojllojshmëri vlerash metaforike; e para është konsideruar si qendra e arsyes, e të menduarit [...], kurse e dyta si motor i realitet tonë fizik [...] (Rey & Chantreau, 1997, 861).

Në vijim do t'i paraqesim shprehjet të cilat i kemi zgjedhur me emra të pjesëve të trupit si: koka, zemra, duart, hunda, syri etj.

Se casser la tête - Çaj kokën - Kuptimi: shqetësohem për dikë a për diçka, tregoj kujdes.

Je ne sais où donner de la tête - S'di ku e kam kokën - Kuptimi: kam shumë halle e telashe sa nuk diç'të bëj më parë, jam i hutuar e s'di ç'të bëj.

En avoir par-dessus la tête - Më doli për hundësh (diçka) - Kuptimi: e pagova shtrenjtë diçka që mora a fitova.

Être sans queue ni tête - Pa kokë e pa bisht - Kuptimi: jo me formë të caktuar, i çregullt, që s'di ku fillon e ku mbaron.

Mettre qqch. dans la tête de qqn. - Ia mbush mendjen (dikujt) - Kuptimi: e bëj të më kuptojë e të më dëgjojë për diçka, i flas shumë dhe e bind.

Avoir la tête au bout du cou - I ka hipur mendja në qiell - Kuptimi: është bërë shumë mendjemadh, i pëlqen vetja i është rritur mendja.

Avoir la tête sur les épaules - Me mendje shtruar, me mendje të mbledhur - Kuptimi: vendosmëri, palëkundje e pamëdyshje për të vepruar.

Avoir un cœur d'or - Ka zemër të artë (dikush) - Kuptimi: është shumë i mirë, është zemërgjerë, i dashur dhe i drejtë; e ka zemrën të artë, e ka zemrën flori, kishte zemër të artë dhe u bënte ballë të gjithave.

Être sans cœur - Nuk ka zemër (dikush); nuk ka shpirt - Kuptimi: është i pamëshirshëm, nuk ndien s'ka dhembshuri.

Avoir le cœur sur la main - Është zemërmirë - Kuptimi: Ka shpirt të mirë, është bujar.

Prendre quelqu'un la main dans le sac - Me duar në preshe (me preshe në dorë), p.sh: Mbreti kërkonte ta zinte me preshe në duar dhe t'ia hiqte gradat.

La main sur la conscience - Me dorë në zemër - Kuptimi: me drejtësi, pa anësi, me dëshirë të mirë, me sinqeritet.

Être comme les doigts de la main - Janë mish e thua - Kuptimi: janë të lidhur fort me njëri-tjetrin, janë një e pandarë, e duan shumë njëri-tjetrin.

Tendre les mains à qqn. - Ia mbaj dorën (dikujt) - Kuptimi: kujdesem për dikë më shumë se për të tjerët, përkujdesem veçanërisht për të.

Avoir qqn. bien en main - E ka në dorë (dikë) - Kuptimi: e ka dikë nën urdhrat et tij, varet krejtësisht prej tij.

Mener (quelqu'un) par le bout du nez - E tërheq për hunde (dikë) - Kuptimi: e bën dikë të sillet si

do ai, t'i bindet verbërisht, e mashtron, luan e tallet me dikë.

Nez à nez - Hundë më hundë; sy më sy; ballë për ballë - Kuptimi: shumë pranë njëri-tjetrit, fare afër.

Faire un long nez - me hundë të varur; me buzë të varur (dikush) - Kuptimi: i zemëruar, i pezmatuar, i ngrysur, me zemërim e me inat, pa folur.

Avoir du nez - Nuhat një gjë (dikush); ka hundë të hollë - Kuptimi: i parandien a i parashikon shpejt

e mirë gjërat, i kap menjëherë.

En un clin d'oeil - Sa çel e mbyll sytë - Kuptimi: shumë shpejt, menjëherë, sa rreh qerpiku.

Pour les beaux yeux - Për sy të zi (të dikujt) - Kuptimi: vetëm sa për t'i bërë qejfin dikujt, për hatër të dikujt.

Avoir le mauvais oeil - Syri i keq (i lig) - Kuptimi: aftësia e njeriut për t'i bërë keq dikujt vetëm duke e parë.

Analiza kontrastive e shprehjeve me konotacion sociokulturor, na ka mundësuar të vërejmë se përveç dallimeve, ekzistojnë edhe ekuivalenca të plota në të dy gjuhët. Këto shprehje të ngurosura që González Rey i quan transnacionale ose paneuropiane, përçojnë vlera të së vërtetës së përgjithshme apo «*urtësisë kolektive*» e cila është universale. Idetë e njëjta transmetohen me të njëjtin vokabular (González-Rey, 2015, 8). Shprehjet e këtilla identike na tregojnë se ekziston një konceptim i realitetit i ndarë midis dy kulturave. Për shembull, shprehja *Avoir un cœur d'or* është plotësisht ekuivalente me shprehjen në gjuhën shqipe *Ka zemër të artë*. Ndërsa sa i përket shprehjes frënge *Avoir la tête au bout du cou*, ajo është e njëjtë për nga kuptimi me atë të gjuhës shqipe *I ka hipur mendja në qiell*, por ndryshon tërësisht për nga simbolika e pjesëve të trupit.

Në shumicën e shprehjeve të analizuara më lart, roli simbolik i konotacionit sociokulturor është shprehur me pjesët e trupit si: koka, zemra, duart, hunda e syri. Me krahasimin e këtyre shprehjeve me konotacion sociokulturor në të dy gjuhët përkatëse, kemi vërejtur ngjashmëri sidomos në vlerat morale e shoqërore dhe sjelljet e individit.

4. Shprehjet me konotacion afektiv

Vështirësitë kryesore gjatë komunikimit ndërmjet njerëzve nuk janë aq shumë pasojë e dallimeve në nivelin e sistemeve gjuhësore, por kryesisht nga niveli i përvojave dhe bindjeve të bashkëbiseduesve. Pikërisht, për këtë arsye edhe shprehjet e ngurosura që përbëhen nga emra të pjesëve të trupit të cilat përdoren për të treguar emocione, ndjenja, afeksione si: gëzim, pikëllim, habi, dëshirë, frikë, dashuri, urrejtje, butësi, paraqesin pengesa për një folës të gjuhës së huaj. Mbështetur në fjalorët e theksuar më lart, ne kemi analizuar një numër të caktuar të shprehjeve të këtilla, duke u munduar të gjejmë sa më shumë ekuivalenca në të dy gjuhët përkatëse. Nga shprehjet e shqyrtuara do të shihet se zemra, shpirti, goja, syri, gjaku, trupi, mëlçia, etj. janë simbolet kryesore të ndjenjave. Këtë do ta paraqesim me ndihmën e shembujve si në vijim:

Donner son cœur - I fal (jap) zemrën (dikujt) - Kuptimi: e dua shumë dikë dhe i besoj pa asnjë lëkundje, lidhem fort shpirtërisht me dikë, dashurohem pas dikujt dhe i jap besën.

Porter qqn dans son cœur - Më ka fjetur në zemër (dikush) - Kuptimi: më ka pëlqyer shumë, më ka hyrë në zemër.

Faire les yeux doux - E bëj për vete (dikë) - Kuptimi: e bëj të më dashurojë, ia rrëmbej zemrën dikujt.

S'en donner à cœur joie - Me gjithë zemër - Kuptimi: me dëshirë të plotë, me kënaqësi e pa asnjë lëkundje (kur bëjmë një urim a një premtim, kur dhurojmë a pranojmë diçka, kur i hyjmë një pune me plot zemër.

Se donner corps et âme - Me mish e me shpirt - Kuptimi: me gjithë forcat e mundësitë, me sa energji kam, pa kursyer asgjë, me dëshirë të madhe.

Rester bouche-bée - mbes pa gojë;mbes me gojë të hapur - Kuptimi: nuk flas dot nga çudia, nga habia, mahnitem me atë që bën a që thotë dikush, me diçka të papritur, të pabesueshme.

Faire mal au cœur - M'u copëtua zemra - Kuptimi: më pikëlloi e më preku thellë (dikush) sa që vuaj shpirtërisht.

Avoir le cœur gros - M'u ça zemra - Kuptimi: u pikëllova shumë (për dikë a për diçka).

Remuer l'âme à qqn - Copëtoj shpirtin (dikujt) - Kuptimi: e lëndova, e shqetësova dikë.

Avoir les foies dans la gorge - I kanë hyrë ethet në bark (dikujt) - Kuptimi: dikush që ka shumë frikë.

Avoir le cœur serré - Me ankth në shpirt - Kuptimi: me frikë se po ndodh diçka, i trembur nga një e keqe që mund të vijë.

Avoir le sang glacé - M'u bë gjaku ujë - Kuptimi: u tremba a u shqetësova shumë nga diçka e keqe.

Nga shprehjet e analizuara me konotacion afektiv, mund të përfundojmë se kuptimi i tyre mund të jetë identik në të dy gjuhët, megjithatë simbolet që i formojnë ato në disa raste janë të ndryshme. P.sh. shprehja e gjuhës frënge *donner son cœur* është identike me shprehjen e gjuhës shqipe *i fal (jap) zemrën*, si për nga kuptimi, ashtu edhe për nga simbolet që e formojnë atë. Ndërsa në shprehjen *avoir les foies dans la gorge*, e cila në gjuhën shqipe përkthehet *i kanë hyrë ethet në bark*, vërejmë se roli simbolik i frikës është paraqitur me *foie (mëlçia)* në frëngjisht, kurse në shqip me *ethet*. Kjo do të thotë se këto dy shprehje për nga ana kuptimore janë të njëjta për shkak se bëhet fjalë për dikë që ka frikë, kurse simbolet që i formojnë ato janë të ndryshme.

5. Përfundimi

Të kuptuarit e një shprehjeje të ngurosur kërkon aftësi frazeologjike, gjuhësore e kulturore, ashtu si edhe aftësi metaforike si në gjuhën amtare ashtu edhe në gjuhën e huaj. Meqë, një ndër kriteret themelore për të vlerësuar dy frazeologjizma si ekuivalente është përputhja semantike, edhe ky punim kishte për qëllim të vë në dukje ngjashmëritë dhe dallimet semantike si edhe ekuivalencat e shprehjeve të ngurosurave në gjuhën frënge dhe në gjuhën shqipe. Analiza e fjalorëve dhe e korpusit tonë na bën të kuptojmë se përtej dallimeve midis dy gjuhëve të cilat kanë një numër të madh shprehjesh me emërtime të pjesëve të trupit si: koka, zemra, syri, hunda, dora etj., e nëpërmjet të cilave pasqyrohen veçoritë kombëtare, kulturore e shoqërore, si edhe mënyra e perceptimit të realitetit nga bartësit e saj, mund të gjenden edhe pika të përbashkëta.

Gjatë krahasimit të këtyre frazeologjizmave, kemi vënë në pah se ka ngjashmëri dhe ekuivalenca sidomos në shprehjet me konotacion afektiv, kurse në shprehjet me konotacion sociokulturor, përkundër ngjashmërive të caktuara, ka më shumë divergjenca.

Si përfundim i gjithë kësaj, mund të themi se përvetësimi i shprehjeve të ngurosurave të një gjuhe të huaj, pa marrë parasysh vështirësitë që hasen, favorizon si aftësitë komunikative ashtu edhe ndërveprimin shoqëror.

Referencat

- [1]. Bally, C. (1951). *Traité de Stylistique française*. Paris: Librairie Klincksieck.
- [2]. Cipo, K. (1949). *Gramatika shqipe*. Tiranë: Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve.
- [3]. Cortès, C. (1988). Phraséologie et corps humain. Etude comparative de la représentation du corps humain dans les expressions phraséologiques en français et en allemand. *Cahiers du C.I.E.L.*, 85-109.
- [4]. Çeliku, M. (1965). *Togje foljore leksikisht të kufizueme në shqipen e sotme*. Tiranë.
- [5]. González-Rey, I. (2007). *Les expressions figées en didactique des langues étrangères*. Cortil-Wodon: Editions Modulaires Européennes.
- [6]. González-Rey, I. (2015). *La didactique du français idiomatique*. Louvain-la-Neuve: Editions Modulaires Européennes.
- [7]. Halimi, H. (1998). *Fjalor tematik frëngjisht-shqip*. Prishtinë: Fakulteti i Filologjisë.
- [8]. Mel'cuk, I. A. (1988). *Dependency syntax: theory and practice*. New York: State University of New York Press.
- [9]. Polguère, A. (2011). Classification sémantique des lexies fondée sur le paraphrasage. *Cahiers de Lexicologie*, 197-211.
- [10]. Rey, A., & Chantreau, S. (1997). *Dictionnaire des expressions et locutions*. Paris: Dictionnaires Le Robert.
- [11]. Sheperi, I. (1927). *Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe, sidomos e toskërishtes*. Vlorë: Shtypshkronja „Vlora“.
- [12]. Thomai, J. (1981). *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*. Tiranë: Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë.
- [13]. Thomai, J. (2010). *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*. Tiranë: Botime EDFA.